

# Material leximi

## Teksti M6-A2 - Çfarë e bënë shkollën, një shkollë të mirë

Vështrimi në disa nivele

Të gjykuarit e cilsisë në shkollë, kërkon një vëzhgim shumështrësor të:

- sistemit shkollor,
- niveleve/viteve të shkollës apo tipeve të veçanta të shkollave,
- objekteve të veçanta shkollore
- orës mësimore në një klasë.


Hulumtimet më të shumta janë bërë rreth pyetjes lidhur me mësimin e “mirë”.

**Qëllimi i përpilimit të njohurive empirike është, për të dhënë udhëzime efektive në variabilitetin e elementëve hyrës dhe të procesit.**

Shkolla e „mirë“

Në një analizë të gjërë sipas disa hulumtimeve amerikane, Mayer, Mullens, Moore & Ralph (2000) arrijnë në dymbëdhjet Variabilitete, me të cilat përcaktohet cilsia e një shkolle bazuar në suksesin e mësimin të nxënësve (shiko grafikonet)

## Variabilitetet e shkollës së mirë



Ndryshimet e rrethit të shkollës i radhiten shkollës, ndërsa ndryshimet e dy grupeve të tjera i radhiten orës së mësimit.

Nga një **numër i madhë i hulumtimeve të veçanta** mund të hartohen tiparet e një shkolle të mirë siç vijonë: (Brookover 1979, Aurin 1991, Steffens & Bargel 1993, Gray & Wilcox 1995, Altrichter & Posch 1997, Fend 1998):

- Një koncept i qartë i shkollës me ide udhëheqëse pedagogjike (shkollat me profil vetanak, që shpie te një kulturë shkollore vetanake);
- Pritje të larta në mësim nga nxënësit dhe nxënëset duke u bazuar në një kapacitet të qartë orientues të shkollës;
- Angazhimi pedagogjik i mësimdhënësve dhe një udhëheqje e orës mësimore me qëllime rezultative;
- Bashkëpunimi i mirë i mësimdhënësve duke u fokusuar në zhvillimin e shkollës
- Sigurimi i disiplinës dhe rregullit në shkollë si kusht minimal;
- Cilsi të udhëheqëse të drejtuesve të shkollës
- Fuksionimi i punës organizative në shkollë;
- Raporte pozitive në mes të shkollës, familjes dhe komunës;
- Klima e besimit të ndërsjellë
- Elementet hyrëse të qarta nga programet mësimore (krahaso gjithashtu Fend 2000).

Raporti në mes të **mjeteve financiare** dhe efikasitetit në shkollë, çdoherë nxisin diskutime. Hulumtimet amerikane tregojnë se me një buxhet të mjaftueshëm të mjeteve financiare, me të cilat disponon shkolla, mund të arrihet efikasiteti i mësimit, dhe se mjetet shtesë nuk luajnë rol në arritjen e efikasitetit të mësimit (pra me rëndësi është se si përdoren mjetet fin. ekzistuese –natyrisht vetëm kur janë të mjaftueshme-)(Burtless 1996). Kështu p.sh u tregua se përdorimi i mjeteve financiare shtesë për trajnimin e mësimitdhënësve, ndikonë më shumë në suksesin e nxënësve në mësime se sa reduktimi i numrit të nxënësve për klasë në kuadër të përbërjes së klasës, pra në mes 18-26/28 nxënës

(Murnane & Levy 1996)

Për dallim nga opinioni i gjërë, madhësia e klasës nuk është faktorë për mos arritjen e suksesit të nxënësve në mësime (Griessmer 1999). Në një klasë me 18 – 26/28 nxënës edhe nëse janë 3 – 5 nxënës më pak apo më shumë nuk luan rol në suksesin e mësimit të nxënësve (megjithatë më shumë punë korrigjuese dhe ngarkesë për mësimitdhënësit). Sipas të gjitha gjasave ky veprim objektiv është pasojë e asaj se mësimitdhënësit nuk e ndryshojnë mënyrën e mësimitdhënies edhe nëse kanë klasë me madhësi të ndryshme. Vetëm tek nxënës të dobët në klasë më të vogla shihen përmirësimet, mirëpo edhe kjo është një çështje e cila në kohën e fundit vihet në kontestohet (Nye, Hedges & Konstantopoulos 2002).

### Vazhdimsitë praktike

Nëse provojmë ti përmbledhim ndryshimet e elementëve hyrës dhe proceseve të zbuluara në disa studime të veçanta, të cilët udhëzojnë për një shkollë të „mirë“ ,atëherë arrijmë tek ndryshimet e elementëve hyrës dhe proceseve të paraqitura në tabelë.

Kjo d.m.th. se nuk guxojnë të interpretohen si faktor absolut të cilësisë, të cilët e përbëjnë vetë cilësinë e shkollës. Këto shërbejnë si deklarime aktuale.

**Ndryshimet e elementëve hyrës(Inputeve) dhe të proceseve në sektorin  
jashtëmësor**

Cilsia e elemnteve hyrëse: sistemi shkollor	Cilsia e elemneteve hyrëse: shkollat e përkatëse	Cilsitë e procesit në sektorin: jashtë mësorë
<p>MASHT Programet mësimore</p> <p>Krijimi i autonomisë së shkollës</p> <p>Bashkësia e shkollës (ligji i arsimit 2002)</p> <p>Sistemi i testimit</p> <p>Politika e financave dhe ajo e pagave në sistemin shkollor</p>	<p>Planet mësimore të shkollës</p> <p>Organizimi i shkollës , udhëheqja e shkollës, plani zhvillimor shkollor</p> <p>Koncepti i bashkëpunimit me prindër dhe nxënës</p> <p>Trajnimi I mëtejshëm të mësimeve karakteri i mësimeve pritja e suksesit (niveli i kërkesave)</p> <p>Kultura e testimit</p> <p>Nxënësit (gjendja sociale, aftësit intelektuale, njohuritë gjuhësore)</p> <p>Synimi për rregull dhe disiplinë</p> <p>Rregullat e sjelljes në shkollë</p>	<p>Proceset e zhvillimit të shkollës</p> <p>Udhëheqësia</p>

## Kriteret e orës së „mirë“ të mësimit

### Kriteret e orës së „mirë“ të mësimit (përzgjedhje)

(Doyle 1986, Good & Brophy 1986, Dubs 1995, Weinert & Helmke 1996, Shuell 1996, Hogan & Pressley 1997, Brophy 1998, Waxman & Walberg 1999, Haenisch 1999, Brophy 2000, Walberg & Paik 2000, Hattie & Clinton 2001, Oser & Baeriswyl 2001, Waibel 2003)

<b>Kriteret</b>	<b>Indikatorët</b>
<b>Kriteret didaktike</b>	
Rëndësia dhe sfidat e synimit të mësimit	Synimet mësimore janë sfiduese për nxënësit. Synimet mësimore janë të rëndësishme për nxënësit. Synimet mësimore janë të kuptueshme.
Krijimi i strukturave të diturisë (ndërlidhshmëria)	Dituria organizohet në lidhshmëri (zhvillimi i strukturave të diturisë në vend të akumulimit të diturisë pa ndonjë lidhshmëri).
Përdorimi i dijës	Dituria përdoret, për mundësimin e përjetimit të zotësisë dhe të suksesit. Nxënësit duhen të jenë në gjendje që këto njohuri ti transferojnë (përdorin) në jetën e përditshme.
Planifikimi sistematik dhe strukturimi i orës mësimore.	Krijimi i orës mësimore është i orientuar kah qëllimet mësimore. (Vija treguese ose ecuria është e dallueshme) Ora mësimore zhvillohet, bazuar, në njohuritë paraprake. Mësimdhënësi mundohet të krijoj lidhshmëri në mes të elementeve të shumta të diturisë dhe të strukturave.
<b>Kriteret motivuese</b>	
Qëllimi për mësim	Nxënësve u shpjegohet rëndësia dhe kuptimi i lëndëve. Shpjegohet përse duhet mësuar diçka.
Karakteri sfidues, ilustrativë dhe i rëndësishëm	Mësimi është: – sfidues – ilustrativ dhe – i rëndësishëm

<p><b>Kriteret teorike të mësimdhënies dhe të nxënies</b></p>	
<p>Përkrahje nxënësve për zhvillimin e mendimit analitikë, kritik dhe kreativ.</p>	<p>Mësimdhënësi në mënyrë permanente i nxitë nxënësit në të menduar për...</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjidhjen e problemit,</li> <li>- orientim kah synimi, dhe</li> <li>- i orienton se si ti bartin njohuritë në jetën e përditshme</li> </ul> <p>në përputhje me aftësitë e tyre.</p>
<p>Udhëheqja e mësimnxënies nga mësimdhënësi</p>	<p>Udhëheqja e procesit të mësimnxënies përbëhet prej - një përzierje optimale- nga...</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– puna direkte e mësimdhënësit me nxënës (duke mësuar fillestarët dhe nxënësit e dobët)</li> <li>– dhe konsultimi në mësimnxënie me nxënësit e mirë.</li> </ul>
<p>Përkrahja e mësim të vetëudhëhequr</p>	<p>Mësimdhënësi ka për synim të udhëheqë mësimnxënie të pavarur dhe me kalimin e kohës krijon më shumë hapsira për këtë.</p>

Kriteret	Indikatoret
<b>Kriteret metodike</b>	
Baraspeshimi i metodave të shumta	<p>Në orët e mësimit varësisht nga qëllimet mësimore dhe kushtet paraprake të nxënësve përdoren metoda të ndryshme. (Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies).</p> <p>Për suksesin e mësimit nuk është vendimtare një metodë e caktuar, por se, a aktivizohen nxënësit në mënyrë të duhur në secilën metodë (bile edhe ligjërimi i mësimdhënësit mund të jetë efektiv përmes pyetjeve dhe detyrave të shtruara qëllimisht, kur bëhet fjalë për përcjelljen e shumë njohurive orientuese në një orë të shkurtër mësimi).</p>
Ilustrimet dhe mjetet ndihmëse	<p>Përdorimi i ilustrimeve është i efektshëm, nëse orientohet drejtpërdrejt kah synimet. Një prezentim i zhvilluar përmes prozhektorit apo përmes tabelës , ngrit efektivitetin e mësimnxënies.</p> <p>Mësimdhënia përmes demonstrimit të dokumenteve, modeleve, eksperimenteve dhe simulimeve ngrit suksesin e mësimnxënies.</p>
Krijimi i leksioneve të veçanta	<p>Krijimi i leksioneve duhet të jetë i qartë për nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për problemin lidhur me lëndën.</li> <li>– Nxënësit duhet të vërejnë se përse shtjellohet një lëndë dhe cilat qëllime duhet ti arrijnë.</li> <li>– Gjatë shpjegimit të lëndës, kuptimi duhet të jetë në rend të parë.</li> <li>– Mësimet e mësuara duhet të përforcohen përmes ushtrimeve.</li> <li>– Ajo që është mësuar duhet ti bashkangjitet një strukturë dhe ndërlidhshmërie të përgjithshme.</li> </ul>
Detyra shtëpiake	<p>Duhet të ipen detyra shtëpiake kreative, dhe duhen të jenë të harmonizuara me qëllimet mësimore.</p> <p>Detyrat shtëpiake duhet të vlerësohen dhe të diskutohen.</p> <p>Detyrat e shtëpisë duhet të shpërndahen gjatë mësimit, kështu që nxënësit të kuptojnë, se çfarë duhet të kryejn, dhe në rast të vështirësive të marrin ndihmesa.</p>
<b>Kriteret e sjelljes së mësimdhënësve</b>	
Fuqia e entuziazmit dhe motivimit si dhe orientimi në lëmi dhe në rezultate	<p>Mësimdhënësit tregojnë entuziazëm të dukshëm për lëmin e tyre profesionale.</p> <p>Ata orientohen në standarde të larta profesionale (kërkesa të larta, por që mund të përmbushën për shkak se qëllimet janë të qarta).</p>

	<p>Ata ngrisin motivimin e nxënësve, duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– i aktivizuar shpesh nxënësit dhe mundësisht të gjithë,</li> <li>– pritur suksese pozitive nga nxënësit</li> <li>– u mundësuar nxënësve raste për suksese dhe duke u ndihmuar të përjetojnë ndjenjën e suksesit ,</li> <li>– ngrisin vetëbesimin e nxënësve.</li> </ul>
<p>Udhëheqja emocionale pozitive</p>	<p>Atmosfera në orën e mësimit është pa frikë</p> <p>Ekziston një tolerancë e lartë për gabime (për proceset e mësimit gabimet shihen si domethënëse).</p> <p>Për udhëheqjen e orës së mësimit mësimitdhënësi përdorë mjete pozitive për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Inkurajim dhe përforcim (mirënjohje)</li> <li>– Hyrje në problemet e mësimit dhe në probleme të tjera</li> <li>– Mbështetje gjatë vështirësive në mësim</li> <li>– Interesim në suksesin e nxënësve.</li> </ul> <p>Kjo përkrahë ndjenjat pozitive (Simpatia, kënaqësia) dhe menjanon ndjenjat negative (frikën, zilin dhe zemërimin).</p>
<p>Cilësia e lartë në relacionin mësimitdhënësi-nxënës</p>	<p>Mësimitdhënësi me sjelljen e tij kërkon krijimin e kulturës së bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjellë, me respekt dhe përgjegjësi të plotë.</p> <p>Bashkëpunimi në mes të nxënësit dhe mësimitdhënësit, nga pikëpamja e mësimitdhënësit, karakterizohet përmes sygjërimeve si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– përfillje (përkujdesje)</li> <li>– kalkulimet në sjellje</li> <li>– durimi</li> <li>– vlerësim dhe ngrohtësi emocionale.</li> </ul>
<p>Teknikat e sjelljes së mësimitdhënësit në orën e mësimit</p>	<p>Mësimitdhënësi shfrytëzon orën e mësimit vetëm për punë lidhur me materien e mësimit, njëkohësisht duke u orientuar kah nxënësit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– udhëzimeve të shkurtëra dhe pengimin e ndërprerjeve,</li> <li>– një tempoje optimale të orës së mësimit, e cila na jep kohë për pasqyrim dhe përpunim individual,</li> </ul> <p>Aftësi për aktivizimin e nxënësve me teknika të duhura të pyetjeve dhe impulseve teknika për informata kthyesë (përforcim).</p> <p>Shprehjeve të qarta, të strukturuar dhe gjuhë të kuptueshme</p>

	<p>Aftësia për fokusim (kthimi i dialogjeve të mësimit në një struktur, përmbledhje e kohë pas kohshme).</p> <p>Aftësia për të kthyer interesimin e nxënësve të demotivuar dhe të lodhur, në mësimin drejt qëllimeve.</p> <p>Aftësia për kontrollim dobiprures, për udhëheqjen e drejt të mësimit dhe diagnostifikim (provime, teste, kontrollime).</p> <p>Aftësia për të diagnostifikuar vështirësitë dhe ndihmën individuale në mësim.</p>
<p><b>Udhëheqja e klasës</b></p>	
<p>Udhëheqja e klasës me efikasitet (levërdi) duke parandaluar pengesat mundshme</p>	<p>Mësuesi tregon një kontroll aktiv të situatës në mësim me synim një disiplinë të mjaftueshme.</p> <p>Ai i jep nxënësve rregulla të arsyeshme të cilat edhe i aplikon.</p> <p>Ai është dashamirës, por këmbngulës dhe ia arrin qëllimit.</p>

## Teksti M6-A3 - Faza 1 - Përzgjedhja e fushveprimeve shkollore

<b>Fushëveprimet shkollore</b>	<b>Pjesët e fushëveprimit</b>	<b>++</b>	<b>0</b>	<b>--</b>
Kultura, synimet e shkollës	Cilësia e vizionit,			
	Aftësia e shkollës për inovacione,			
	Të qenit përgjegjës ndaj; Prindërve, univerzitetit, punëdhënësit etj...			
	Kontaktet me jashtë,			
	Rregull dhe disiplinë në shkollë,			
	Preokupimi për mirëqenien e nxënësve,			
	Shkolla si element i jetës shoqërore në regjion ( lokalitet ),			
	Klima shkollore			
Mësimi	Cilësia e planit mësimor,			
	Cilësia e mësimdhënies			
	Cilësia e kapacitetit të nxënësve dhe të klasave			
	Stërngarkimi i mësimdhënësve (stresi)			
	Kënaqësia e mësimdhënësve dhe nxënësve në mësim			
Udhëheqësia e shkollës	Cilësia e drejtorit (udhëheqje, menaxhim),			
	Të qenit i pranueshëm			
Jeta shkollore	Cilësia e kujdesit ndaj nxënës,			
	Cilësia e aktiviteteve jashtëmësimore			
Organizimi i shkollës	Cilësia e organizimit dhe rrjedha e punës në shkollë,			
	Të qenit i kënaqur me organizimin			
Resurset	Cilësia e përdorimit të resurseve			

## Teksti M6-A4 - Faza 2 - Përcaktimi i vlerës së duhur

<b>Fushveprimet shkollore</b>	<b>Vlera e duhur e dëshiruar</b>
Atmosfera shkollore	Më shumë se 50% të nxënësve janë të mendimit, se atmosfera në shkollë është e mirë. Më shumë se 50% të mësimitdhënësve janë të mendimit, se atmosfera në shkollë është e mirë;
Opinionimi mbi shkollën nga pikëpamja e prindërve	Opinionimi i mirë i prindërve 60%
Mësim	Mësim superior sipas vlerësimit të zgjedhur
Udhëheqësia	Vlerësime të larta në formularin vlerësues
Komplekset shkollore	Opinionimi i mirë i nxënësve

## Teksti M6-A5 - Faza 3 - Përcaktimi i metodës matëse

### Përcaktimi i metodës dhe instrumentit matës si dhe grupit të personave për matje

Pas përcaktimit të vlerave të duhura duhet të përcaktohen patjetër metodat matëse, që të jetë e mundur marrja e **Gjendjes-Është**.

Lidhur me këtë duhet të vendosen se cilat metoda duhet të përdoren

- metoda se si të mblidhen informatat dhe
- ato grupe të personave të cilët janë të përfshirë duhet të vendosin.

Ky vendim varet nga faktoret në vijim:

- Koha, për zhvillimin e instrumentëve matëse dhe pranimi i gjendjes-Është dhe
- Saktësia e deklaratave dhe të dhënave të përmbledhura.

Instrumentet e zhvilluar vetë janë më me ndikim, se ata të pranuar të gatshëm, për shkak se përpunimi i instrumenteve ka një kontribut të madh për zhvillimin e shkolles.

(Tabela jepë një pasqyrë mbi metodat për ngritjen e Gjendjes-Është në shkolla (Burkard 1996; MSWWF 1999; një prezentim të përmbledhur me instrumente, të cilat shquhen për hulumtimet shkencore, dhënë Murgatroyd & Morgan 1993, 158).

### Metodat për ngritjen e gjendjes-Është

Metoda matëse	Format (Instrumentet për hulumtim)
Raport	Raport i lirë
Bisedë e strukturuar	Doracak Lista kontrolluese
Pyetësor	Formulari Pyetje me karta
Vështrim	Përshkrimi në formë të lirë Vështrimi i listës kontrolluese
Përparësia-Dobësia-Analiza	Përparësia -Dobësia-Analiza

## Shembuj për metoda matëse

<b>Fushë-veprimi shkollor</b>	<b>Vlerat e duhura</b>	<b>Metoda/ Instrumenti</b>
Klima shkollore	Më shumë se 50% të nxënësve janë të mendimit, se klima në shkollë është e mirë, Më shumë se 50% të mësuesve janë të mendimit, se klima shkollore është e mirë;	Përpunimi i formularit përmes këshillit të mësuesve dhe këshillit të nxënësve
Opinionit mbi shkollën nga pikëpamja e prindërve	Opinionit i mirë i prindërve 60%	Formularë për prindërit (të zhvilluar vetë): përgjegjja nga prindërit
Mësim	Mësim i avancuar sipas vlerësimit të zgjedhur	Zhvillim vetanak i formularit për vlerësim: të plotësohet nga nxënësit
Udhëheqësi a	Vlerësime të larta në formularin vlerësues	Plotësimi i formularit nga këshilli i mësimdhënësve
Komplekset (hapësirat) shkollore	Opinionit i mirë i nxënësve 60%	Një projekt – pune për klasat e zgjedhura nga lënda e gjuhës shqipe rreth temës “përmirsimi i hapësirës dhe paisjeve shkollore”

## Instrumentet matëse

### Raportet

Mësimdhënësit luten, që të përmbledhin një raport për një fushëveprim të caktuar shkollorë, për të cilin duhet vlerësuar cilësinë,.

#### **Shembuj:**

(1) Një shkollë bën një avansim të mësimdhënësve, në mënyrë interne, mbi "Didaktikën profesionale në lëmin e kimisë". Një vit më vonë përmbledhen përparimet, në të cilën mësimdhënësit mund të përshkruajnë një raport të lirë, se çfarë kanë bërë për këtë temë në vitin e kaluar në orët e tyre të mësimit.

(2) Një shkollë ka përpunuar një plan mësimor intern në lëmin e "arsimit ekonomik". Në fund të vitit luten nxënësit, të përshkruajnë në mënyrë të lirë, se çfarë kanë mësuar ata. Këto deklaratatë të nxënësve do të krahasohen me planin mësimor, që nga kjo të nxirren konkluzionet mbi ndikimin e planit mësimor.

## Bisedat e strukturuar

Personat e ngarkuar me matje drejtojnë rrethin e personave, bisedave të strukturuar. Bisedat e strukturuar nuk bëhen rastësisht, por bëhen sipas një udhëzuesi ose një liste kontrolluese, me qëllim që të përpunohen njohuritë.

### Shembuj:

(1) Vizatimi jep një shembull të një doracakut, qëllimi i të cilit është, të përmbledh cilësinë e rrjedhave administrative. Do të pyeten mësimmshënësit. Ata duhet të bëjnë edhe propozime, që janë të thjeshta, efektive dhe që kanë si synim rrjedhat e punës.

### Shembulli i një doracakut për një bisedë të strukturuar

Fushëveprimi shkollor: Synimi: Arsyetimi:	Rrjedhshmëritë e detyrave administrative në shkollë Procesi duhet të jetë i thjeshtë dhe efektivë Rrjedhat e mira administrative ngrisin kënaqësinë e mësimmshënësve		
Pyetje për këtë bisedë	Përgjigjet	Propozime përmirësimi	Masa të mundshme përmirësimi
<p><b>1 Financat</b></p> <p>1.1 Si shkon procesi për miratimin e të hollave për riparime?</p> <p>1.2 A është ky process i duhur , apo keni ju ndonjë propozim për ta përmirësuar?</p> <p>1.3 A janë për ju formularët e përdorur të aplikueshëm?</p>			
<p><b>2 Mosvijueshmëria</b></p> <p>2.1 A ka rregullore për mosvijueshmërin në shkollë?</p> <p>2.2 Mënyra e informimit të drejtorit për mosvijueshmërinë?</p> <p>dhe kështu më radhë.</p>			

(2) Tabela në vazhdim tregon një listë kontrolluese për një bisedë të strukturuar me mësimdhënësit. Qëllimi i kësaj është, që të maten kontaktet e mësimdhënësve në veçanti me prindërit.

### Shembulli i një **liste kontrolluese** për një bisedë të strukturuar

Fushëveprimi shkollor: Synimi: Justifikimi:		Kontakti me prindër Kontaktet me prindër Marrëdhënia e mësimdhënësve me - prindër është gjithmonë e rëndësishme në pikëpamje të problemeve edukative.	
Pikat e bisedës	Rezultatet	Vërejtjet	Masa të mundshme përmirësimi
<b>1 Takimet e prindërve</b>			
1.1 Numri i takimeve me prindër			
1.2 Tematika e takimeve me prindër			
1.3 Numri i përafërt i pjesëmarrësve			
<b>2 Biseda me prindër</b>			
2.1 Numri i bisedave me prindër			
2.2 Përmbajtja e bisedave			
2.3 Kush e ka bërë iniciimin për bisedë			
<b>3 Përvoja personale</b>			
3.1 Cila është dobja			
3.2 Përvoja pozitive			
3.3 Problemet personale			
<b>4 Mbështetja nga udhëheqësia e shkollës</b>			
4.1 Vëllimi dhe cilësia e mbështetjes			
4.2 Vlerësimi i njohurive me udhëheqësin e shkollës			
4.3 Plani për bashkëpunim me prindër.			
dhe kështu më radhë.			

## Marrja në pyetje

**Gjendja-Është** e një fushëveprimi shkollorë, lejon që përmes marrjes në pyetje të

- Mësimdhënësit,
- nxënësit,
- prindërit ose
- personelit administrativ

të nxirret një evidencë për shkollën. Mund të përpunohet me anë të

- instrumenteve shkencore apo
- pyetësorit të vetë të shkollës.

Gjatë përpilimit të një pyetësi duhet të kihet parasysh krijimi i dy detyrave:

- (1) Krijimi i pyetjeve (formulimi i pyetjeve) dhe
- (2) krijimi i pyetësorit.

Gjatë **përpilimit të pyetjeve** duhet të kihet parasysh këto pika, si:

1. Cilat njohuri duhet të nxirren nga pyetja?  
A është pyetja e parashtruar ashtu që informacionet e nxjerrura të jenë të vlefshme për hulumtimin e temës?
2. Përgjigja në këto pikëpamje të para mundëson klasifikimin e pyetjeve:
  - **Rregullimi ose natyra e pyetjeve:** Ato përqendrohen në gjykimin ose dëshirën e një gjendjeje faktike.

**Shembull:**a) A duhet shkollat të kenë organizatë të nxënësve të autorizuar mbi një bashkëpërcaktim?

po  jo

b) Shkolla duhet të ketë një organizatë të nxënësve mbi një bashkëpërcaktim.

për  kundër

c) Shkolla duhet të posedoj një organizatë të nxënësve mbi një bashkëpërcaktim.

për  1  2  3  4  5 kundër

Formulimi i fundit mundëson shkallëzimin e shprehjes së mendimit.

**Pyetjet bindëse:** Të pyeturit duhet të parashtrajnë, se çfarë konsiderojnë se është drejt / gabim gjegjësisht e vërtetë / jo e vërtetë.

**Shembull:**a) Nëse detyrat shtëpiake ipen me një synim atëherë kanë ndikim në rezultatet e mësimin.

drejt  gabim

= Pyetje e diturisë

b) A duhet mësimdhënësit të shpërndajnë detyra shtëpiake?

po  jo

= Pyetje bindëse

- **Pyetje rreth sjelljes:** Ato përqendrohen (me të vërtetë ose qëllimisht) në sjellje gjegjësisht në veprimet e personave të pyetur.

**Shembull:** Bisedoni me një klasë, të cilën e merrni për herë të parë përsipër, për rregullat e sjelljes dhe të rregullores?

po  jo

3. Kur pyetja është e përpiluar, duhet të bëhet strukturimi formal i pyetjeve. .

Dallimi bëhet në mes të pyetjeve të hapura dhe të mbyllura.

- Tek **pyetjet e hapura** nuk ipet përgjigje. Përparsia e tyre është, që të pyeturit nuk kthehen në një drejtim të caktuar. Përgjegjet e plotëfuqishme janë vetëm atëherë, kur të pyeturit kanë një masë kompetenca për të folur. Kërkesë e plotë është vlerësimi i pyetjeve të hapura.

Shprehjet e plotëfuqishme prej pyetjeve të hapura mund të rriten, nëse përpilohen pyetje të qarta, të cilat qojnë gjithmonë prej së përgjithëshmes drejt mënyrës së shikimit specifik.

**Shembull:** A keni kontakt me kolegët dhe koleget jashtë orarit të punës?

po  jo

Nëse po, sa shpesh?

Të cilës natyrë janë këto kontakte?

profesionale?

shpirtërore?

Nëse jo, çfarë duhet të bëhet?

Aktivitet profesional për mësimdhënësit?

Takime shpirtërore?

- **Paraprakisht, pyetjet e mbyllura** japin përgjegje. Këtu ka forma të ndryshme të dhënies së përgjegjes: dy kategori të përgjegjes ( p.sh. po/jo, saktë/jo e saktë), përgjegje të shumta me alternativa të përcaktuara (pyetje me zgjedhje të shumëfishta), tek të cilat një apo më shumë përgjegje janë të sakta, të cilat duhet radhiten (sipas rëndësisë, kuptimit) .

**Shembull:**a) A ndjeheni të stërngarkuar në shkollën tuaj?

po  jo

b) Çfarë duhet të bëhet sipas mendimit tuaj, që të zbuten stërngarkesat e mësimdhënësve në shkollën tuaj?

Largimi i leksionit të obliguar

Reduktimi i numrit të nxënësve për klasë

Reduktimi i detyrave për zhvillimin e shkollës

Tek pyetjet e mbyllura ekziston rreziku, që të pyeturit të kenë vështërsi në renditjen e deklaratave, për shkak se spektri i dhënë i përgjegjeve është shumë pak i diferencuar ose jo i saktë. Për këtë zgjedhja e përgjegjeve të bëhet me kujdes. Tek pasiguritë e mëdha propozohet një testim paraprak ose së paku një përgjegje tjetër si " të tjera apo të mëtutjeshme ... dhe edhe ...". Këso pyetjesh përshkruhen si **Pyetje Hibride**. Është e mundshme gjithashtu, futja e Kategorisë-"Nuk e di", për shkak se me këtë menjanohen përgjegjet e paqëllimshme. Nëse duhet të bëhet një evidentim i mendimeve dhe i vlefshmërisë së lartë, mund të parashtrohen të ashtuquajtura **Pyetje të dy niveleve**, tek të cilat të pyeturit marrin njohuri, se a kanë në përgjithësi një mendim apo një qëndrim, që, të mbështetur në ndonjë rast mund të japin me një pyetje të dytë pëlqimin apo refuzimin e tyre.

**Shembull:** Nëse mësimdhënësit paraqesin një rregull shtëpiake të mirë, atëherë jeta shkollore do të jetë më në rregull. A keni ndonjë mendim lidhur me këtë shprehje?

po  jo

Nëse po, mbështeteni?

pajtohem  refuzoj

- Përfundimisht, pyetjet direkte dhe jo direkte duhet të krahasohen.

Me **pyetjet direkte** kontaktohet personalisht me të pyeturit (p.sh. Çfarë mendoni për ...?)

Tek pyetjet indirekte hulumtohet për një rrugë tjetër (p.sh. mbi një rrugë tjetër të një historie të shkurtër, tek e cila shprehen mendime të ndryshme lidhur me një problem), ku të pyeturit mund të vendosin se me cilin

mendim mund të pajtohen më së pari. Pyetjet indirekte duhet të kontribuojnë në fushat kritike, që të pyeturit të përgjegjen më parë.

4. Më në fund duhet të formulohen pyetjet. Me këtë, formulimi i fjalive dhe zgjedhja e fjalëve kanë një rol vendimtar. Duhet të kemi kujdes në këto rregulla:

- Çdo pyetje duhet të drejtohet për një gjendje faktike (pyetje njëdimensionale). Dimensionalitetet e shumta (dy apo më shumë gjendje faktike në një pyetje) qojnë në përgjegje jo të qarta.

**Shembull:** A ka kontribuar marrja e masave në zhvillimin e shkollës tuaj, për përmirësimin e cilësisë dhe a është dhënë kohë e mjaftueshme? (gabim)

A është dhënë kohë e mjaftueshme në shkollën tuaj për zhvillimin e masave shkollore?

A keni kontribuar në përmirësimin e cilësisë së shkolles? (më mirë)

- Pyetjet duhen të jenë të baraspeshuara, kjo do të thotë, të mos ketë vetëm mundësi për përgjegje pozitive apo negative, por që mund të mirren që të dyja.

**Shembull:** A duhet të jetë dita e shtunë ditë e lirë e shkollës? (gabim)

A duhet të jetë e dita e shtunë ditë e lirë e shkolles apo një ditë normale mësimi në shkollë? (më mirë)

- Pyetjet duhet të jenë të formuluar në mënyrë neutrale, pra të mos përmbajnë ide shpifëse ose prejudikime.

**Shembull:** Mateni ju në kuptim të traditës pedagogjike se çfarë kuptimi ka mësimi i mëtutjeshëm

Frontal? (gabim)

Çfarë kuptimi ka mësimi frontal nga aspekti juaj pedagogjik? (më mirë)

- Pyetjet duhet të përmbajnë fjalë të qarta (të papërshtatshme janë shprehjet si "normal", "shpesh", "sipas rastit", "nganjëherë". Në këto raste duhet të ipen të dhëna të qarta: "asnjëherë, njëherë deri dyherë, triherë dhe më shumë".

- Pyetjet duhet të jenë shkurtra (përafërsisht 20 fjalë të jetë maksimumi).

- Duhet të kihet kujdes i posaqëm kur haset në pyetjet e ndishme (probleme të cilat i përkasin karakterit dhe mënyrës së sjelljes së një personi të vështirë). Pyetjet e ndishme të parashtruara direkt qojnë deri tek një përgjegje të gabuar ose mospërgjegje. Këto pyetje duhet të parashtrihen në mënyrë indirekte. Sipas rastit ato mund të lehtësohen apo zbuten (në vend se të pyetet për saktësinë në mësim mund të pyetet gjithashtu edhe për shprehinë lidhur me fillimin e mësimit) ose mund të apelohe me

efektin e bashkëvepruesit (jo, secili llogaritë saktë hargjimet, si qendroni ju me këtë), ose të mundohet, që të pyeturit të "kapen të befasur" (pasqyroni ju se në çfarë mënyre, herën e fundit nuk e keni korrigjuar dhe vlerësuar provimin).

Me një mundim paksa më të vogël, se formulari pyetës dhe lista e kritereve të strukturuar, janë **pyetjet me karta** (Horster 1992). Mësimdhënësit dhe nxënësit pranojnë karta me pyetje, të cilat lidhen me fushëveprime të caktuara shkollore, që duhet të maten. Shprehjet spontane radhiten dhe mund të ipen udhëzime për vlerën e dëshiruar si dhe rezultate për Analizën-**Është**.

Në vazhdim do të ipen disa shembuj rreth marrjes në pyetje.

## Formulari pyetës për prindër rreth përshtypjeve të tyre për shkollën

Fushëveprimi shkollor:	Bashkëpunimi shkollë - prindër
Synimi:	Bashkëpunimi i hapur dhe me cak
Justifikimi:	Cilësia e bashkëpunimit shkollë – prindër, me problemet sociale në rrethin shkollor, që para së gjithash është domethënëse për zhvillimin e fëmijeve
<b>1 Mbarëvajtja e fëmiut tim në shkollë</b>	
1.1	<p>Si ndihet fëmiu juaj në shkollë?</p> <p><input type="checkbox"/> Shumë mirë</p> <p><input type="checkbox"/> Mirë</p> <p><input type="checkbox"/> mjaftueshëm</p> <p><input type="checkbox"/> Jo mirë</p> <p>Arsyetimi kryesor për këtë vendim: _____</p> <p>_____</p>
1.2	<p>Si e vlerësoni ju ngarkesën e fëmiut tuaj me punën në shkollë?</p> <p><input type="checkbox"/> Shumë i ngarkuar</p> <p><input type="checkbox"/> I ngarkuar</p> <p><input type="checkbox"/> mesatar</p> <p><input type="checkbox"/> I ngarkuar pak</p> <p>Çfarë dëshironi ju ndryshe, lidhur me ngarkesën?</p> <p>_____</p> <p>_____</p>
